

Festoi me armë pas golit të Manajt – tifozi përfundon në pranga në Prishtinë!



11/10/2025 22:50

f

t

l

Pas golit të fitores së Shqipërisë ndaj Serbisë, një qytetar ka festuar në mënyrë të rrezikshme duke shtënë me armë zjarri në rrugën “Rexhep Luci” në Prishtinë.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 21:30, dhe siç konfirmon për [lajmi.net](#) zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Prishtinës, Enis Pllana, njësitet policore kanë reaguar menjëherë duke arrestuar një të dyshuar në vendin e ngjarjes.

“Rreth orës 21:30 kemi pranuar informatën për gjuajtje me armë zjarri në rrugën Rexhep Luci në Prishtinë. Njësitet policore kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes dhe kanë arrestuar një person të dyshuar. Lidhur me rastin nuk ka persona të lënduar,” ka deklaruar Pllana për [lajmi.net](#).

Sipas burimeve, personi i arrestuar kishte shtënë me armë nga gëzimi pas golit të Rey Manajt, që i dha fitoren Shqipërisë kundër Serbisë me rezultat 0:1 në ndeshjen kualifikuese për Botërorin 2026.


Policia ka konfiskuar armën dhe është duke trajtuar rastin sipas procedurave ligjore.[/lajmi.net/](#)

LAJME TË FUNDIT

- 

“Drejtësi për çlirimtarët”-Edi Rama i jep mbështetje protestës...
- 

Brukseli kërkon certifikim të rezultateve të raundit të...
- 

Presidentja pas pranimit të çmimit në Lubjanë: Rrugë...
- 

Cilat janë 17 Komunitet që shpall në balotazh,...

Artikuj të ngjashëm



October 13, 2025
“Drejtësi për çlirimtarët”-Edi Rama i jep mbështetje protestës së 17 tetorit...



October 13, 2025
Brukseli kërkon certifikim të rezultateve të raundit të parë, bën thirrje...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information